



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 606, Datë 01.04.2019

**“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Tyson Foods të disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 01.04.2019, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Tyson Foods të disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, i ndryshuar, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari “Për njoftimin e përqendrimit” dhe Udhëzimi “Për procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Tyson Foods të disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë;

**VËREN SE :**

**Procedura dhe Transaksioni**

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me nënshkrimin e “Marrëveshje Shitblerje”, ndërmjet palëve (1) BRF GMBH (shitësi), (2) BRF S.A. (garantuesi i shitësit), (3) BRF Global GMBH, (1) Tyson International Holding Co (blerësi) dhe (2) Tyson Foods, Inc (garantuesi i blerësit).

*Pala Blerëse:* Tyson International Holding Co. është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të shtetit Delaware e kontrolluar 100% nga shoqëria mëmë Tyson Foods Inc, një shoqëri multinacionale, e fokusuar në ushqime me përqendrim të lartë proteine.

*Pala Shitëse:* **BRF GMBH** është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Austrisë, e zotëruar 100% nga shoqëria mëmë BRF S.A. me objekt aktiviteti industrializim, marketing, shitje me pakicë dhe shumicë dhe shfrytëzim i ushqimit të përgjithshëm, veçanërisht produktet shtazore proteina dhe produktet ushqimore duke përdorur zinxhir të ftohtë si suport dhe shpërndarës; ofrimi i shërbimeve të ushqimit në përgjithësi.

**BRF Global GMBH** është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Austrisë, e cila zotërohet 100% nga kompania BRF GMBH.

*Shoqëritë target:* janë aktualisht pjesë e grupit BRF, me seli qendrore në Brazil dhe janë përpunuese të integruara vertikalisht të pulave, me fabrika përpunimi në Tailandë dhe në Bashkimin European. Këto shoqëri importojnë dhe përpunojnë mish në Bashkimin European.

### **Vlerësimi i përqendrimit**

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë:

- I). tregu përkatës i produktit, dhe
- II). tregu përkatës gjeografik.
  - **Tregu përkatës i produktit:** Sa më sipër, si dhe referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit, duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionit, do të jetë tregu i furnizimit dhe tregtimit të mishit për konsum njerëzor.
  - **Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i **Republikës së Shqipërisë**.

Transaksioni i propozuar e i njoftuar është përfitim kontrolli nga shoqëria Tyson Foods i disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë.

Shoqëritë target dhe shoqëria blerëse Tyson Foods së bashku kanë pjesë tregu më pak se 1% të tregut shqiptar duke sjellë kështu një prezencë shumë të kufizuar të palëve në Shqipëri.

Transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Tyson Foods të disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**